



Prishtinë: 15.11.2018  
Kodi i ZRRE-së: V\_1071\_2018

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1870\_09\_18**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **02.10.2018**.

### në seancën e mbajtur më datë 15.11.2018, nxori këtë:

#### V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin Z. P. nga Prishtina, me shifër të konsumatorit: DPR - 90084456, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK\_V\_1870\_09\_18** i datës 02.10.2018.

#### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 06.11.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik nr.4851384 ka qenë e verifikuar nga KEDS. Në ankesë është theksuar se analiza e DMK/ZRRE se shpenzimi i konsumatorit prej 322 kWh deri 405 kWh dhe shpenzimi i përgjithshëm prej 71,786 kWh nuk pshtë real nuk qëndron pasi që konsumatori përderisa nuk ka e pasur njehsorin e regjistruar nuk ka mundur ta dijë shpenzimin. Gjithashtu në ankesë është theksuar edhe raporti i kalibrimit ku nuk është dhënë asnjë vërejtje nga komisioni. Vendimi i DMK/ZRRE nuk bazohet as në mesatare të shpenzimit të konsumatorit por e anulon dhe e ngarkon me shpenzimin e periudhës 01/2014. Në ankesë është theksuar se KEDS edhe përkundër zvogëlimit të humbjeve po dëmtohet nga ZRRE me këtë rast pasi nuk po pranohet ai shpenzim. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_1870\_09\_18 i datës 02.10.2018 për konsumatorin Z. P. me shifër DPR - 90084456.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 15.11.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik nr.4851384 ka qenë e verifikuar nga KEDS, Bordi i ZRRE-së thekson se punëtorët e autorizuar të KEDS-it për pranimin e njehsorit elektrik me datën 06.03.2013 kanë dalur te konsumatori për të bërë pranimin e instalimit të njehsorit elektrik nr.4851384 me gjendje TL=00000/70218 kWh dhe TU=000000 kWh, dhe është theksuar se njehsori është teknikisht në rregull, mirëpo nuk kanë dhënë asnjë të dhënë tjetër si sa ka ardhur deri te ky shpenzim i energjisë elektrike i regjistruar. Bordi i ZRRE gjithashtu thekson se KESCO në përgjigjen e tyre dhënë konsumatorit nuk ka dhënë asnjë sqarim se si ka ardhur deri te kjo ngarkesë financiare e periudhës 03/2013, pasi nuk ka dhënë asnjë sqarim se si ka mundur të vijë deri të ky shpenzim i regjistruar i energjisë elektrike, kur vërehet se shpenzimi i konsumatorit pas periudhës kontestuese nuk përputhet me shpenzimin e faturuar në periudhën kontestuese. Gjithashtu KESCO nuk ka dhënë asnjë sqarim me shkrim se si ka ardhur deri te kjo ngarkesë financiare kur dihet se punëtorët e autorizuar të KEK-ut dhe KEDS-it sipas Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji dhe Procedurës për Leximin dhe Faturimin e konsumatorëve tarifor për çdo muaj kanë obligim për të bërë leximin dhe faturimin e pikës matëse.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se analiza e DMK/ZRRE se shpenzimi i konsumatorit prej 322 kWh deri 405 kWh dhe shpenzimi i përgjithshëm prej 71,786 kWh nuk pshtë real nuk qëndron pasi që konsumatori përderisa nuk ka e pasur njehsorin e regjistruar nuk ka mundur ta dijë shpenzimin, Bordi i ZRRE-së thekson se kjo nuk qëndron, pasi që krahasimi i shpenzimeve është një indikator mjaft i rëndësishëm në analizimin dhe shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve. Bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike aktive të shifrës DPR – 90084456 vërehet se konsumatori prej periudhës 03/2013 e tutje ka lexim dhe faturim të rregullat të pikës matëse. Sipas analizave të bëra rrjedhës së energjisë elektrike aktive vërehet se konsumatori pas faturës së muajit 03/2013 ka lexim dhe faturim të rregullt të pikës matëse, dhe se në muajin 06/2016 është bërë ndërrim i njehsorit elektrik nr.4851384, dhe është vendosur njehsori nr.64692486. Sipas analizave të shpenzimit të energjisë elektrike të konsumatorit vërehet se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik nr.4851384 prej periudhës 04/2013 deri më 06/2016 ka qenë 405.00 kWh/muaj, si dhe mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik nr.64692485 prej periudhës 06/2016 deri më 08/2018 ka qenë 322 kWh/muaj. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike konsumi i konsumatorit për periudhat e mëhershme me njehsorin elektrik nr.4851384 (duke mos e përfshi periudhën kontestuese) ka qenë: viti 2014 - 263.17 kWh/muaj, viti 2015 - 305.42 kWh/muaj, ndërsa për periudha të mëvonshme me njehsorin e ri elektrik nr.64692485: viti 2017 - 283.42 kWh/muaj. Pra, bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike aktive Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se konsumi i energjisë elektrike i konsumatorit pa e përfshi periudhën kontestuese (periudha 03/2013) nuk ndryshon mes njehsorëve të cilat kanë qenë në funksion te konsumatori. Nga kjo mund të konstatohet se fatura e energjisë elektrike e periudhës 03/2013 e ngarkuar me shpenzim prej 71,842 kWh nuk paraqet shpenzim real mujor dhe se as për afërmi nuk përputhet me shpenzimin e faturuar pas periudhës kontestuese. Se shpenzimi i energjisë elektrike pas periudhës kontestuese nuk përputhet as për së afërmi me shpenzimin e faturuar në periudhën kontestuese prej 71,786 kWh e dëshmon edhe fakti se shpenzimi i përgjithshëm i konsumatorit prej periudhës 04/2013 e deri më 09/2018 është 24,372 kWh.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO është se në raportin e kalibrimit nuk është dhënë asnjë vërejtje nga komisioni, Bordi i ZRRE-së thekson se punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit me datë 17.08.2016 kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr.4851384 dhe gjatë kontrollimit kanë konstatuar se njehsori elektrik bllobat i ka në rregull, nga ana e jashtme dëmtime nuk ka, në brendi të njehsorit elektrik komisioni nuk vërejtur ndonjë parregullsi. Duhet theksuar se ZRRE ka kërkuar nga KEDS të na sigurohet edhe procesverbali i shqyrtimit të saktësisë së njehsorit elektrik, por që KEDS ka siguruar vetëm procesverbalin e kontrollimit teknik dhe jo të shqyrtimit të saktësisë,



e që do të duhej të bëhej edhe shqyrtimi i saktësisë për të vërtetuar saktë gjendjen e njehsorit elektrik.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 15.11.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Arsim Janova, u.d. kryesues

\_\_\_\_\_  
Besim Sejfiqaj, anëtar

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit Z. P. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.